



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datë 11.08.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Udh. Udh. Udh.	06
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	1545/23
Nr. Faq. Br. Str. Nr. Page.	02
Data Datum Date	11-08-2023
PRISHTINË	

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1186/23, për zyrtarin e lartë z. Besnik Imeri, Drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Vitisë, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

A r s y e t i m

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, sipas të cilit z. Imeri duke qenë zyrtar i lartë publik, njëkohësisht ka mbajtur edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat ("Besnik Q.Imeri B.I."), situatë kjo e cila bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-1255/23), e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë z. Imeri është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit nuk mundet që njëkohësisht të ushtrij edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit."

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pranuar informacione (06-1521/23) me dokumentet përcjellëse (informatat e biznesit), në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1. dhe 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Bufeshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

